

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2024

Lënda: GJEOGRAFI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim dhe arsytim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Figura është marrë nga një satelit i motit nëpërmjet rrezeve infra të kuqe. Çfarë tregon zona që në figurë është më e errët? **1 pikë**

- A) Mbulesën më të hollë të reve
B) Natën
C) Rrymat oqeanike
D) Hijen e Hënës



2. Elvira po bisedonte me një shoqe, e cila po i fliste për vendin e saj. Ajo po i tregonte që në vendin ku jeton, Dielli lind çdo ditë të vitit rreth orës 06:15 dhe perëndon rreth orës 18:15. Elvira u çudit, pasi në Shqipëri Dielli lind dhe perëndon në kohë të ndryshme gjatë vitit.

Në cilat gjerësi gjeografike gjendet vendi që jeton shoqja e Elvirës?

1 pikë

- A) Në gjerësitë gjeografike polare
B) Në gjerësitë gjeografike subpolare
C) Në gjerësitë gjeografike mesatare
D) Në gjerësitë gjeografike ekuatoriale

3. Koha e njëjtë e rrotullimit të Hënës rreth vetes së saj dhe rreth Tokës shoqërohet me:


1 pikë

- A) luhajtje të vogla të temperaturës gjatë vitit hënor
B) kohëzgjatje të ndryshme e ditë-natës hënore me vitin hënor
C) ekspozim të dy gjysmësferave të Hënës ndaj Tokës
D) kohëzgjatje të njëjtë të ditë-natës hënore me vitin hënor

4. Figura e parë tregon pozicionin e Tokës përkundrejt Diellit në një ditë të caktuar të vitit. Pikat nga A në E tregojnë disa vende në sipërfaqen e Tokës. Vija e ndërprerë tregon boshtin e Tokës. Cila nga pjesët e figurës së dytë, tregon në mënyrë të saktë këndin e rënies së rrezeve të Diellit në pikën C?

1 pikë

- A) 1
B) 2
C) 3
D) 4



5. Gjerësinë gjeografike më të vogël e kanë vendet që ndodhen në:

1 pikë

- A) ekuator
B) tropikë
C) rathët polarë
D) pole

6. Cila është tendenca e lëvizjeve të rrymave oqeanike?

1 pikë

- A) Rrymat oqeanike të ftohta lëvizin nga gjerësitë e vogla gjeografike drejt gjerësive më të mëdha gjeografike.
B) Rrymat oqeanike të ngrohta lëvizin nga gjerësitë e vogla gjeografike drejt gjerësive më të mëdha gjeografike.
C) Rrymat oqeanike të ftohta lëvizin vetëm në zonat e ftohta polare.
D) Rrymat oqeanike të ngrohta lëvizin vetëm në zonat e ngrohta ekuatoriale.

7. Tjetërsimi fizik, që ndodh për shkak të luhatjeve të temperaturës gjatë 24 orëve, shfaqet më shumë në:


1 pikë

- A) zonat detare
- B) zonat e tundrës
- C) zonat shkretinore
- D) zonat e pyjeve me lagështirë

8. Bazuar në grafikun e dhënë, kufiri i borës së përhershme është më i ulët në zonat me gjerësi:

1 pikë


- A) polare,
- B) mesatare,
- C) tropikale,
- D) ekuatoriale.



9. Për paraqitjen e relievit të treguar në figurë janë përdorur:

1 pikë

- A) Izobaret
- B) Izohipset
- C) Izohietat
- D) izobatet



10. Gadishulli i Krimesë gjendet në:

1 pikë

- A) Detin e Veriut
- B) Detin e Norvegjisë
- C) Detin e Zi
- D) Detin Balltik

11. India është pjesë e rajonit të:

1 pikë

- A) Azisë Lindore
- B) Azisë Jugore
- C) Azisë Juglindore
- D) Azisë Qendrore

12. Cili nga pohimet e mëposhtme është përcaktues për imigracionin?

1 pikë

- A) Procesi i largimit të një grupi njerëzish nga një territor i caktuar.
- B) Procesi i ardhjes së një grupi njerëzish në një territor të ri.
- C) Procesi i largimit të një grupi njerëzish nga një shtet në një shtet tjetër.
- D) Procesi i lëvizjes së një grupi njerëzish brenda kufijve të një rajoni.

13. Cili nga shtetet dallohet për numrin e madh të gejzerëve:

1 pikë

- A) Suedia;
- B) Islanda;
- C) Norvegjia;
- D) Danimarka.

14. Cili nga faktorët e mëposhtëm është përcaktuesi më i rëndësishëm i klimës në Rajonin e Evropës Perëndimore? **1 pikë**

- A) ndikimi i veprimtarisë së njeriut
- B) ndikimi i rrymave oqeanike
- C) largësia nga deti
- D) format e relievit

15. Deti i Veriut dallohet për rezerva të mëdha të: **1 pikë**

- A) hekur-nikelit.
- B) boksidgeve.
- C) kromit.
- D) naftës.

16. Medvegja është një nga krahinat e trevave shqiptare, që ndodhet në përbërje të: **1 pikë**

- A) Serbisë
- B) Kosovës
- C) Malit të Zi
- D) Maqedonisë së Veriut

17. Shqipëria ndodhet midis koordinatave gjeografike $39^{\circ}38'$ – $42^{\circ}39'$ gjerësi gjeografike veriore dhe $19^{\circ}16'$ - $21^{\circ}04'$ gjatësi gjeografike lindore. Në këtë mënyrë është përcaktuar: **1 pikë**

- A) pozita gjeografike
- B) kushtet natyrore
- C) lokacioni relativ
- D) lokacioni absolut

18. Pas vitit 1990 e në vazhdim, numri i popullsisë së Shqipërisë pati një rënie të dukshme. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rënien e numrit të popullsisë, kanë qenë: **1 pikë**

- A) rritja e nivelit të vdekshmërisë foshnjore;
- B) shtimi i ulët natyror dhe imigracioni i lartë;
- C) rritja e numrit të vdekjeve në moshën e tretë;
- D) shtimi i ulët natyror dhe emigracioni i lartë.

19. Relievi i Shqipërisë dallohet për kontraste të theksuara hipsometrike. Pasojat e kësaj dukurie vihen re në: **1 pikë**

- A) ndryshimet e mëdha klimatike
- B) veprimtarinë eolike në plazhe
- C) tipat e ndryshme të brigjeve detare
- D) format e ndryshme të peizazhit lumor


Për t'ju përgjigjur pyetjes 20 dhe 21 referojuni tabelës së mëposhtme. Ajo pasqyron të dhëna që tregojnë ndryshimin e temperaturës dhe trysnisë atmosferike në drejtim vertikal.

Lartësia (m)	Temperatura (°C)	Trysnia atmosferike (mb)
0	15	1013
1300	7	875
2500	-1	752
4600	-15	572
6500	-25	466
7800	-34	376

20. Bazuar në të dhënat e tabelës, përcaktoni çfarë ndodh me trysinë e ajrit kur rritet lartësia? **1 pikë**
- A) Trysnia atmosferike rritet.
 B) Trysnia atmosferike zvogëlohet.
 C) Trysnia atmosferike nuk ndryshon.
 D) Trysnia atmosferike herë rritet dhe herë zvogëlohet.

21. Nga të dhënat e tabelës së mësipërme shohim se në lartësinë 7800 m temperatura është -34°C dhe trysnia atmosferike 376 mb. Me çfarë problemi tjetër do të përballë një njeri, nëse ngjitet në këto lartësi, krahas temperaturave të ulëta dhe ndjesisë së të ftohtit të madh? **1 pikë**


22. Lëvizjet e pllakave tektonike formojnë tipa të ndryshëm kufijsh midis tyre, siç tregohen në figurat e mëposhtme.



- a) Cila nga figurat shpjegon teorinë e zgjerimit të tabanit të oqeaneve? **1 pikë**

- b) Cila nga figurat tregon formimin e humnerave oqeanike? Shpjegoni se si ndodh procesi i formimit të humnerave oqeanike. **3 pikë**

23. Soleri jeton në Austri dhe dëshiron të shkojë me prindërit për pushime. Ai ka dëgjuar shumë për tërmetet dhe i ka shumë frikë ato, edhe pse asnjëherë nuk i ka përjetuar. Në hartën e mëposhtme është treguar shpërndarja e pllakave tektonike si edhe kufijtë midis tyre.



- a) Cilën nga zonat në hartën e mësipërme (A, B, C apo D) **NUK** do t'i sugjeroni Solerit për të shkuar me pushime, në mënyrë që ai mos të ketë gjasa të përjetojë tërmetin? **1 pikë**

- b) Jepni një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj. **1 pikë**

24. Shkëmbinj të ndryshëm, në varësi të përbërjes së tyre dhe kushteve në të cilët ata ndodhen, formojnë peizazhe të ndryshme.




a) Emërtoni llojin e peizazhit në figurë. 1 pikë

b) Jepni dy nga kushtet në të cilat ndodh formimi i një peizazhi të tillë. 2 pikë

c) Çfarë duhet të marrin në konsideratë ndërtuesit, kur ndërtojnë në këto zona? 1 pikë

25. Vëzhgoni figurat e mëposhtme.

a) Shpjegoni ndryshimin në formimin e baticave midis figurës 1 dhe figurës 2. 2 pikë



b) Në rast se mund të ndërtohet një stacion për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet shfrytëzimit të baticave dhe zaticave, cili do të ishte disavantazhi i përdorimit të një stacioni të tillë. 1 pikë

26. Zhvillimi global i ekonomisë botërore është shoqëruar me pabarazi hapësinore midis qendrës (vendeve të zhvilluara) dhe periferisë (vendeve në zhvillim). Qendra dhe periferia kanë një lidhje të ndërsjellë duke shkëmbyer midis tyre elementë për të zbutur pabarazitë. Përcaktoni:

a) Dy nga elementet që qendra i jep periferisë në këtë shkëmbim? **2 pikë**


b) Dy nga elementet që periferia i jep qendrës në këtë shkëmbim? **2 pikë**

27. Ministri i shtetit për Drejtësinë dhe Sigurinë në Holandë, deklaroi në prill të vitit 2019 se gjatë dy viteve të fundit, qindra shqiptarë kanë kërkuar azil në Holandë, por çeshtjet e tyre kanë pak gjasa të miratohen, pasi Shqipëria konsiderohet një vend i sigurt i origjinës. Nisur nga ky fakt përcaktoni:

a) një nga faktorët që nxit largimin e popullsisë nga vendi i origjinës. **1 pikë**

b) një nga faktorët që nxit tërheqjen e popullsisë në vendin e destinacionit. **1 pikë**

28. Në figurë paraqiten tri piramida popullsie.



a) Cila nga piramidat është karakteristike për vendet e pazhvilluara të Afrikës. Jepni një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj. **2 pikë**

a) Identifikoni një nga piramidat që tregon plakje të popullsisë. **1 pikë**

b) Evidentoni një pasojë ekonomike të vendeve që vuajnë nga plakja e popullsisë. **1 pikë**

29. Për t'ju përgjigjur pyetjes, bazohuni në hartën e mëposhtme.

a) Cilin rajon tregon në hartë pjesa me ngjyrën më të errët (blu)?

b) Identifikoni një nga lumenjtë më të rëndësishëm të këtij rajoni, që derdhet në gjirin Persik.



1 pikë

1 pikë

c) Cili është kalimi strategjik i rajonit që lidh detin Mesdhe me Detin e Kuq?

1 pikë

30. Tradicionalisht, në strukturën gjinore të popullsisë së Shqipërisë, kanë mbizotëruar meshkujt në krahasim me femrat. Në periudha të ndryshme kohore kjo strukturë është lëkundur.

a) Në cilën periudhë të shek. XX është lëkundur struktura gjinore e popullsisë së Shqipërisë?

1 pikë

b) Jepni një arsye që shpjegon lëkundjen e strukturës gjinore.

1 pikë

c) Si ka ndryshuar moshja mesatare e popullsisë së Shqipërisë nga viti 1990 deri më sot?

1 pikë

31. Pas vitit 1945 Shqipëria ndoqi rrugën e vet për zhvillimin ekonomik të vendit.

a) Cila degë e industrisë mori përparësi në Shqipëri në vitet 1945-1990?

1 pikë

b) A solli rritje të mirëqenies së popullsisë industrializimi i vendit? Jepni dy argumente për të mbështetur përgjigjen tuaj.

3 pikë

32. Malësia e Martaneshit, Çermenikës dhe Gollobordës përbëhen nga formacione të ndryshme shkëmbore.

a) Cila prej këtyre malësive përbëhet kryesisht nga terrigjenë?

1 pikë

b) Shkruani dy nga tiparet e relievit të kësaj malësie:

2 pikë

33. Jepni nga një karakteristikë të Rajonit Juglindor në lidhje me:

3 pikë

Ndërtimin gjeologjik të rajonit

Format e relievit që mbizotërojnë

Llojin e klimës
